

VENDIM
Nr. 463, datë 22.6.2016

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK NË
KOPLIK, MALËSI E MADHE¹**

(Ndryshuar me VKM nr.463, datë 31.7.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit me sipërfaqe 61 (gjashtëdhjetë e një) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 2220, në Koplík, Malësi e Madhe, të përbërë nga parcelat me numrat e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. *Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

3. Veprimtaritë që do të zhvillohen në këtë zonë janë të llojit:

- a) prodhuese, industriale dhe agropërpunimi;
- b) tregtare dhe magazinimi mallrash;
- c) shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është deri në 99 vjet.

5. Zona e teknologjisë dhe e zhvillimit ekonomik jepet me qira, me çmimin 1 euro.

6. Përzgjedhja e zhvilluesit të zonës të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese.

7. Kriteret, në bazë të të cilave do të vlerësohen zhvilluesit, janë:

- a) propozimi i projektit teknik;
- b) ndikimi mjedisor;
- c) ndikimi social;
- ç) kohëzgjatja e punimeve;
- d) kapaciteti financiar i kompanisë dhe mundësia e financimit të projektit.

8. Vendimi nr. 12, datë 4.1.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës ekonomike në Koplík, Shkodër”, dhe vendimi nr. 773, datë 4.6.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike në Koplík, Shkodër, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, shfuqizohen.

9. Ngarkohet *Ministria e Financave dhe Ekonomisë* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

¹ VKM nr. 463, datë 22.6.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.120, datë 28 qershor 2016.
VKM nr.463, datë 31.7.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.118, datë 8 gusht 2018.

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK”, KOPLIK, MALËSI E MADHE
(Zëvendësuar me VKM nr.463, datë 31.7.2018)

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Statusi i pronësisë
1	2220	201/8	arë	985	shtet
2	2220	193	arë	24,823	shtet
3	2220	194	arë	20,878	shtet
4	2220	163	arë	32,801	shtet
5	2220	160	arë	63,747	shtet
6	2220	159	arë	23,942	shtet
7	2220	200	arë	86,417	shtet
8	2220	195/1	kullotë	43,392	shtet
9	2220	157	arë	20,969	shtet
10	2220	158/1	arë	21,397	shtet
11	2220	187/2	arë	55,941	shtet
12	2220	185/4	kullotë	88,552	shtet
13	2220	192	arë	22,000	shtet
14	2221	388	kullotë	73,627	shtet
15	2221	387	kullotë	30,568	shtet
				610039	SHUMA

HARTA E "ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK"
KOPLIK, MALËSI E MADHE, SIPËRFAQJA 61 ha
(Zëvendësuar me VKM nr.463, datë 31.7.2018)



